




Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 13.2 shkronja d) 17 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 5 shkronja d) të Ligjit nr. 03/l-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, dhe nenit 3 të Udhëzimit Administrativ të MASH-it nr. 15/2019 për detyrat, përgjegjësitë procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo – arsimor dhe aftësues para universitar, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 korrik 2020, miraton këtë,

VENDIM PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS

Neni 1

Për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore në Komunën e Podujevës, sipas konkursit me nr.prot.05/306 të shpallur më 22 korrik 2020, ngritet komisioni përzgjedhës, në përbërje:

1. **Selman Gashi**, zyrtar për çështje pedagogjike në Drejtorinë e Arsimit, kryesues
2. **Luljeta Shala**, përfaqësuese e këshillit të prindërve, anëtare
3. Përfaqësuesi i MASHT-it (tani Ministria e Arsimit dhe Shkencës), i/e cili/a caktohet nga po kjo Ministri.

Nga shkolla përkatëse caktohen dy përfaqësues të Këshillit Drejtues (një prind dhe një mësimdhënës) në cilësinë e vëzhguesve.

Neni 2

Komisioni punët dhe detyrat i kryen në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 03/l-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, dhe nenit 3 të Udhëzimit Administrativ të MASH-it nr. 15/2019 për detyrat, përgjegjësitë procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo – arsimor dhe aftësues para universitar.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr. 02-020/04-0040788/20
Podujevë, 30 korrik 2020



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi